

# GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025

(java e pesëmbëdhjetë, deri më 13.04.2025)

## TË DHËNA JAVORE


### Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë javës së pesëmbëdhjetë të vitit 2025 (nga 07-13.04.2025) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 283 ( $I=15,4/100.000$ ) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngashme me gripin, për 11,3% më pak se javën e kaluar.

Krahasuar me javën e pesëmbëdhjetë të vitit të kaluar (145) numri është rritur për 95,2%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (127) është regjistruar një rritje prej 2,2 herë.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit korrespondon me aktivitetet të ulët të virusit (Grafiku 1).

**Grafiku 1.** Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025




153 raste janë regjistruar tek grupmosha 15-64 vjet, 39 tek fëmijët nga 5-14 vjet, 48 tek personat mbi 65 vjet dhe 43 tek fëmijët nga 0-4 vjet. Incidencë më e lartë (44,6/100.000) është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në 18 QSHP/NJR : Shkup – 113, Tetovë – 43, Gostivar – 33, ndërsa në të tjerat numri është  $\leq 20$ .

Në 14 njësi raportimi është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 4 sezonal. (hartogrami 1).

**Hartogrami 1.** Niveli i aktivitetit të virusit të gripit sipas incidencës në 100.000 banorë, java e pesëmbëdhjetë, 2025



Gjatë kësaj javë nuk janë raportuar raste të vdekjes së pasojë e gripit.

### MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së pesëmbëdhjetë janë raportuar gjithsej 35 raste me SARI. Numri më i madh i rasteve me SARI ( $n=22$ ; 62,9%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje respiratore të fëmijëve - Kozle. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI ( $n=18$ ; 51,4%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 248, asnjë person nuk është i shtruar në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet 14,1% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

### MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (rutinore + SARI)

Në javën e pesëmbëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 28 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI.

Është regjistruar 1 rast pozitive me grip - Influenza B Victoria..

Janë regjistruar 7 raste me RSV, në 5 RSV-A dhe në 2 RSV-B.

### **TË DHËNA KUMULATIVE**

#### Mbikëqyrja epidemiologjike

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **25.613** ( $I=1.394,5/100.000$ ).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=14.788), numri i rasteve të regjistruar ka shënuar një rritje prej 73,2%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=20.716) është regjistruar një rritje prej 23,6%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 29 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=6.863) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (5.550,9/100.000) është regjistruar në territorin e Dibrës (1.062).

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) – 14.655 raste (57,2%), ndërsa incidencë më e lartë (3.070,8/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=2.964).

Shpërndarja e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve:

- titor – 195 raste ose 0,8%
- nëntor – 259 raste ose 1,0%
- dhjetor – 570 raste ose 2,2%
- janar – 7.710 raste ose 30,1%
- shkurt - 11.210 raste ose 43,8%
- mars – 5.067 raste ose 19,8%
- prill (deri më 13.04.2025) – 602 raste ose 2,3%.

Deri më tani janë regjistruar 5 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

#### MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes së gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e që ka për qëllim fitimin e informacionit më të detajuar për incidenten, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për zbatimin e masave parandaluese në kohë. Mbikëqyrja sentinel SARI kryhet në 6 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU e Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile, KU për Sëmundjet e Fëmijëve, KU e Alergologjisë dhe Pulmologjisë, SPQ 8 Shtatori dhe KU për Sëmundje Respiratore tek Fëmijët - Kozle) në një në Shtip (SK Shtip). Definicioni për rastet SARI sipas të cilët zbatohet mbikëqyrja është në përputhje me definicionin e rastit të dhënë nga OBSH-ja në vitin 2014.

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së pesëmbëdhjetë janë raportuar gjithsej 1.161 raste me SARI, me 20 persona në kujdes intenziv. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=457; 39,4%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje tek fëmijët. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=582; 50,1%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 6.754. Nga të gjitha pranimet, 17,2% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë prej 20,6% është regjistruar tek personat e grupmoshës nga 0-4 vjet.

Janë regjistruar 9 raste të vdekjes, 2 në moshë nga 30-64 dhe 7 mbi 65 vjet, me komorbiditete dhe të pavaksinuar. Tek katër prej tyre është vërtetuar Influenza, dhe atë: 2 raste me Influenza A(H3), 1 me Influenza A(H1)pdm09 dhe 1 me Influenza A - e patipizuar.

#### MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (rutanore + SARI)

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e pesëmbëdhjetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.150 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Të gjitha materialet janë testuar edhe për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe / ose RSV.


Janë detektuar 284 raste pozitive me grip. (Tabela 1)

Janë regjistruar 10 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe 100 raste me RSV.

**Tabela 1.** Shpërndarja, numri dhe përqindja e materialeve pozitive nga mbikëqyrja rutinore dhe sentinel sipas origjinës dhe numrit, RMV, 2024/2025

Lloji dhe nënloji i virusit	Origjina		Sezoni 2024/25	
	rutinor	Sentinel SARI	numri	%
Influenza A	<b>86</b>	<b>86</b>	<b>172</b>	<b>60,6%</b>
Influenza A/H1pdm	15	25	40	23,3%
Influenza A/H3	64	54	118	68,6%
Influenza A – e pasubtipizuar	7	7	14	8,1%
Influenza B	<b>81</b>	<b>31</b>	<b>111</b>	<b>39,4%</b>
Influenza B Victoria	80	31	110	99,1%
Influenza B – linjë e papërcaktuar	1	0	1	0,9%
SARS-CoV-2	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>10</b>	-
RSV	<b>15</b>	<b>85</b>	<b>100</b>	-
RSV-A	9	59	68	68,0%
RSV-B	6	26	32	32,0%

**Grafiku 2.** Shpërndarja javore, numri dhe përqindja e mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja sentinel dhe rutinor, RMV, 2024/2025



### KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Numri i sëmundjeve të ngjashme me gripin, po shënon rënje por vazhdon të jetë mbi kufirin favor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e mbikëqyrjes virologjike të gripit tregojnë se ka një aktivitet rajonal të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënavë, Maqedonia e Veriut ka intensitet mesatar të virusit të gripit.

## MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

\*Burimi : <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtjen nga gripi kanë për qëllim mbrojtjen nga sëmundjet akute të frymëmarrjes dhe nga ato mund të ketë përfitime të mëdha, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Shmangni mbledhjen dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, veçanërisht shmangni kontaktin e ngushtë me njerëz të sëmurë ose të dyshimtë – me kollë, teshtimë, temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose dezinfektues.
- Mjediset e banimit mbani të ngrohura dhe ajrosni ato shpesh.
- Vishuni me veshje të ngrohta me shtresa dhe larje me ujë të ngrohtë.
- Konsumoni pije të ngrohta (çaj dhe supë), lëngje frutash dhe ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C ( limon, portokall) janë ato që rekomandohen më shumë. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë në sispozicion, mund të përdoren edhe pije dhe preparate me multivitamina.
- Bëni një stil jete dhe zakonesh të shëndetshme, pushoni dhe fleni irë, ushqehuni shëndetshëm, bëni aktivitetit fizik dhe ruajeni qetësinë mendore dhe reduktoni stresin.

Imuniteti i mirë i trupit do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose të përballeni më lehtë me gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht i shëndetshëm dhe keni një sistem të fortë imunitar, prapëseprapë mund të infektoheni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmurenit nga gripi?

Ndiqni këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë apo vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një fasuletë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidheni atë në koshin e plehrave.
- Mbani maskë mbrojtëse kur jeni në kontakt me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagura që përmbajnë alkool ose dezinfektues duarsh.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën në të cilën qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbani mjedisin tuaj të pastër – gjësendet, sipërfaqet me produkte higjenike shtëpiake.

Nëse jeni mbi 65 vjeç ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkon ndihmë nga mjeku.

## VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnjerable (sipas rekomandimeve të OSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloj në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk).

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e ketij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.376 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cenueshme të popullatës.

2.600 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjeter të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.919 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.296 persona me vaksina falas dhe komerciale.

### RAJONI EVROPIAN

\*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e katërmëdhjetë të vitit 2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit në Rajonin Evropian të OSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 9 nga 31 vende të rajonit evropian të OSH-së.
- Edhe pse ka variacione në vende të ndryshme, numri i rasteve pozitive tashmë ka arritur kulminacion, por aktiviteti edhe Influenza B mbetet dominant.
- Pozitiviteti i RSV ka shënuar ënie, por mbetet i lartë dhe më i lartë është tek grupmosha 0-4 vjet.
- Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët në të gjithë rajonin, me variacione të caktuara në disa vende.

Nga 35 vende të cilat raportojnë për intensitetin e gripit: 9 kanë raportuar për intensitet mesatar dhe të lartë.

Nga 34 vende të cilat raportojnë për shpërndarjen gjeografike të gripit: 24 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë të virusit të gripit.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse  
Instituti i Shëndetit Publik**